

MENDIM PAKICE

Unë, komisionere Xhensila Pine, relatores e trupit gjykues për subjektin e rivlerësimit Eranda Laze, votova për shkarkimin nga detyra të këtij subjekti, pasi nuk ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, kusht ky i përcaktuar në nenin 59, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016.

1. Lidhur me dy apartamentet e banimit me sip. 181.2 m², në *, Tiranë, vlera 81,284 euro**

Lidhur me këto pasuri të paluajtshme, të cilat janë krijuar pas lidhjes së martesës së subjektit të rivlerësimit me personin e lidhur dhe gjatë ushtrimit të funksionit të subjektit, kam vlerësuar se subjekti i rivlerësimit së bashku me bashkëshortin i nënshtrohen detyrimit për justifikimin e burimit të deklaruar, i cili ka shërbyer për të dy nën regjimin e bashkësisë ligjore, për krijimin e një pasurie të përbashkët në kuptim të nenit 73 e vijues të Kodit të Familjes, si detyrim i cili buron nga përcaktimi i nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

Kufijtë e kontrollit të pasurisë së personit të lidhur, që ka shërbyer për krijimin e pasurisë objekt hetimi, kontrolli dhe verifikimi i kursimeve të deklaruara që janë përdorur si burim për blerjen e apartamenteve, duhet t’i nënshtrohen hetimit administrativ për t’i përcaktuar dhe vlerësuar këto sipas parimeve të përcaktuara nga neni 30 i ligjit nr. 84/2016, sipas logjikës se pasuria në fjalë është krijuar nga të dy bashkëshortët, në një raport bashkëpronësie ideale prej 50% secili.

Nga analiza e akteve të administruara përgjatë procesit të rivlerësimit, rezulton se kjo pasuri është deklaruar se është blerë prej subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj në vitin 2009, duke identifikuar si burim të krijimit: (i) të ardhurat nga emigracioni të bashkëshortit; (ii) aktiviteti privat dhe publik i bashkëshortit; (iii) kredia e marrë.

Të ardhurat nga emigracioni u analizuan duke u kryer një analizë financiare, nga ku rezultoi se për vitet 1998 – 2004 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka pasur të ardhura në vlerën 80,308 euro dhe shpenzime jetike në vlerën 33,118 euro, duke rezultuar me mundësinë për të kursyer në vlerën 47,190 euro.

Në drejtim të identifikimit të burimeve lidhur me të ardhurat nga emigracioni, të cilat janë deklaruar nga subjekti dhe personi i lidhur se kanë shërbyer për krijimin e **dy apartamenteve të banimit me sip. 181.2 m² në ***, Tiranë**, rezultoi se në deklaratën fillestare të pasurisë të personit të lidhur në vitin 2008, ka deklaruar se me të ardhurat nga emigracioni ka blerë: (i) një banesë në bashkëpronësi në qytetin e Durrësit, në vlerën 875,000 lekë, për pjesën e tij takuese; (ii) një apartament banimi me sip. 80 m² në qytetin e Vlorës, në vlerën 52,000 euro.

Këto deklarime lidhur me burimet nga të ardhurat nga emigracioni, të përdorura për pasuritë objekt hetimi, kanë mangësi të theksuara në vlerën e tyre provuese, pasi janë të pambështetura nga të dhëna që vijnë nga hetimi administrativ, nuk provohen nga analiza financiare e kryer, si dhe kanë edhe defektin e rëndësishëm në drejtim të besueshmërisë së tyre, për sa kohë ato vijnë në kundërshtim, së paku me deklaratimet që vetë këta individë kanë dhënë për përdorimin e tyre si burime të pasurive të tjera të tyre, blerë më përpara në kohë, ndaj ato nuk mund të merren në konsideratë në analizën financiare.

1.1 Lidhur me pagesën e këstit të parë të apartamenteve në vlerën 40,000 euro

Në rezultatet e hetimit administrativ, subjektit lidhur me pagesën e këstit të parë iu kalua barra e provës, si vijon:

Subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare që me të ardhura të ligjshme të paguajë në datën 22.12.2009 këstin prej 40,000 euro, pasi ka rezultuar me balancë negative në shumën 6,408,671 lekë në analizën e kryer për vitin 2009.

Subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur mundësi financiare që me të ardhura të ligjshme të kursejnë vlerat e deklaruara në deklaratën fillestare të pasurisë të vitit 2008, konkretisht depozitën bankare në vlerën 10,000 euro dhe kursimet cash në vlerën 30,000 euro, pasi kanë rezultuar me balancë negative në shumën 6,830,100 lekë në analizën e kryer për periudhën 12/1998 – 26.9.2008.

Në përfundim të procesit, pretendimet e ngritura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës nuk mund të pranohen e pasqyrohen në analizën financiare, referuar arsyetimit si vijon:

Për sa nga analiza financiare e kryer deri në vitin 2008 nuk provohet mundësia që me burime të ligjshme të jetë krijuar gjendja në llogarinë e përbashkët bankare në vlerën 10,000 euro dhe gjendja cash 30,000 euro, të cilat janë përdorur si burim për financimin e apartamenteve, objekt hetimi, ato nuk mund të përfshihen në analizën financiare për vitin 2009.

Deklarimet për të ardhurat e siguruara prej punësimit të personit të lidhur në sektorin privat mbetën vetëm në nivel deklarativ dhe të pambështetura në asnjë dokument shkresor me vlerë provuese, për pasojë mbeti e paprovuar marrëdhënia e punësimit dhe të ardhurat e fituara prej saj e, për rrjedhojë, edhe pagimi i detyrimeve tatimore që sigurojnë ligjshmërinë e tyre sipas përcaktimit të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016.

Lidhur me të ardhurat e personit të lidhur gjatë ushtrimit të veprimtarisë si avokat për vitin 2009, pas analizimit të parashtrimeve të subjektit vlera e fitimit për vitin 2009 do të rezultonte 1,680,000 lekë, vlerë kjo që duhet të përfshihet në analizën financiare për vitin 2009.

Analiza përfundimtare financiare për pagimin e këstit të parë të apartamenteve në vitin 2009

Analiza financiare për pagesën e këstit të parë të apartamenteve	Dhjetor 2009
Pasuritë	5,647,916
Dy ap. banimi, të bashkuara në 1, në bashkëpronësi me bashkëshortin, me sip. 181.2 m ² , ***, Tiranë	5,518,400
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	<i>129,516</i>
Gjendja e likuiditeteve	707,582
Detyrime	(771,803)
Kredia në NBG Bank sipas kontratës datë 13.8.2008	
<i>Pagesë kësti (principal + interes) nga data 26.9.2008</i>	<i>(771,803)</i>
Pasuri net (pasuri - detyrime)	6,419,719
Të ardhurat	2,305,651
Të ardhurat nga paga, subjekti	236,946
Të ardhurat e subjektit nga leja e lindjes	304,432
Të ardhurat nga aktiviteti i bashkëshortit si avokat	1,680,000
Të ardhurat nga interesat bankarë	84,273
Shpenzimet	614,603
Shpenzime jetike	364,320
Shpenzime udhëtimi	250,283
Mundësia për kursime	-4,728,671

Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit pas kalimit të barrës së provës së burimit të krijimit të të ardhurave të deklaruara nga personi i lidhur nga emigracioni i ish-in edhe të ardhurat e familjarëve të bashkëshortit të saj nga emigracioni, ky deklaram nuk mbështetet nga deklaramet periodike dhe as nga faktet e rezultuara nga hetimi administrativ.

Lidhur me këtë pretendim, ai nuk mund të pranohet, pasi procesi hetimor administrativ i zhvilluar prej organeve të rivlerësimit nuk mund të jetë një proces që fton/lejon subjektet të bëjnë deklarime të reja, më të volitshme për vlerësimin e pasurisë së tyre. Ata janë të ftuar të japin shpjegime e të paraqesin prova që mbështesin deklaramet e tyre dhe jo të modifikojnë deklaramet në përputhje me problematikat e prezantuara. Verifikimi i deklarimeve është një proces, i cili nuk mund të ndërtohet mbi deklarime të bëra rishtas.

Në funksion të kryerjes së një procesi të rregullt që garanton të drejtat e palës dhe në zbatim të parimit të proporcionalitetit dhe objektivitetit, edhe nëse do të pranohet dhe do të konsiderohet në analizën financiare se si burim për krijimin e pasurive të saj dhe personit të lidhur me të kishin shërbyer edhe të ardhurat e familjarëve të bashkëshortit deri në vitin 2004, kohë kur bashkëshorti u kthye për të jetuar në Shqipëri, mundësia për kursim nga emigracioni e gjithë familjes së personit të lidhur, pasi janë zbritur shpenzimet jetike për gjithë familjen deri në vitin 2004, do të ishte në vlerën 74,632 euro.

Duke i shtuar këtyre të ardhurave nga emigracioni edhe të ardhurat e provuara me dokumentacion provues ligjor për bashkëshortin, pas kthimit të tij nga emigracioni nëpërmjet punësimit në sektorin publik në Shqipëri, për vitet 2006 – 2008, në vlerën 2,622 euro, të ardhurat do të rezultojnë në total në vlerën 77,254 euro.

Duke kryer një analizë krahasuese mes mundësisë për kursim të vlerës 77,254 euro, me investimet e bashkëshortit (apartamenti në qytetin e Vlorës në vitin 2009, në vlerën 52,000 euro dhe shtëpia e blerë me vëllain në qytetin e Durrësit në vitin 2004, në vlerën 13,808 euro), diferenca në vlerën 11,446 euro nuk do të provonte burimin e ligjshëm të krijimit të likuiditetit bankar dhe gjendjes *cash* të deklaruar në vlerën totale 40,000 euro.

Analiza financiare në vitin 2009, për subjektin dhe personin e lidhur për pagimin e këstit të parë të apartamenteve, duke konsideruar si vlerë të provuar me burime të ligjshme 11,446 euro, do të rezultonte me balancë negative në vlerën -3,149,582 lekë.

Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur gjenden në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të financuar pagesën e këstit të parë për blerjen e kësaj pasurie dhe përballimin e shpenzimeve, situatë faktike e cila kualifikohet sipas përcaktimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

1.2 Lidhur me pagesën e këstit të dytë të apartamenteve në vlerën 11,284 euro

Në rezultatet e hetimit administrativ, subjektin lidhur me pagesën e këstit të dytë iu kalua barra e provës, si vijon:

Nga analiza financiare duket se subjekti dhe bashkëshorti i saj nuk kanë pasur mundësi me të ardhura të ligjshme të kryejnë pagesën për apartamentet në shumën 11,284 euro, në datën 10.1.2014, pasi ka rezultuar me balancë negative në shumën -1,544,990 lekë.

Në përfundim të procesit, disa nga pretendimet e ngritura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës nuk mund të pranohen e pasqyrohen në analizën financiare, referuar arsytimit si vijon:

Nga hetimi administrativ, referuar dokumentacionit ligjor provues nga ASHK Tirana Rurale 1, në praktikën e regjistrimit janë depozituar dy mandatarkëtimi:

a. Mandatarkëtimi nr. ***, datë 22.12.2009, për pagesën e shumës 40,000 euro, me përshkrimin “Kësti i shtëpisë arkëtuar nga E.L në favor të shoqërisë “***” sh.p.k.”;

b. Mandatarkëtimi me nr. serial ***, datë 10.1.2014, për pagesën e shumës nga E.L në vlerën 11,284 euro, me përshkrimin “Për blerje apartamenti në favor të shoqërisë “***” sh.p.k.”.

Në deklaratën periodike të vitit 2010, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se për pasuritë objekt hetimi ka paguar vlerat 40,000 euro, kësti i parë i sipëranalizuar, dhe 30,000 euro nga kredia bankare, duke mos e deklaruar pagesën prej 10,000 euro.

Mandatarkëtimi me nr. serial ***, datë 10.1.2014, përbën provë për pagimin e detyrimit të mbetur në janar të vitit 2014.

Deklarimi i subjektit në përgjigje të pyetësorit nr. 2 dhe pretendimi i saj pas kalimit të barrës së provës se shuma 10,000 euro është shlyer në fund të vitit 2010, kohë kur është dorëzuar edhe apartamenti, nuk mbështetet nga asnjë provë e dokumentacion ligjor dhe mbetet vetëm deklarativ e i pambështetur nga faktet e rezultuara nga hetimi administrativ dhe nuk mund të kundërshtojë vlerën provuese të mandatit me nr. serial ***, datë 10.1.2014, si i vetmi dokument ligjor me fuqi provuese, që konfirmon kohën e kryerjes së pagesës së këstit të dytë të blerjes së apartamenteve.

Pretendimi i subjektit se kjo vlerë u pagua në vitin 2010, nuk mbështetet nga deklarimi periodik vjetor i subjektit dhe personit të lidhur në vitin 2010.

Bazuar në pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, në funksion të nenit D të Aneksit të Kushtetutës për kontrollin e saktësisë dhe mjaftueshmërisë së deklaramit dhe burimit të ligjshëm të pasurisë, deklaratat periodike kanë vlerën e provës në procesin e rivlerësimit. Deklarata e pasurisë për vitin 2010 është provë që vërteton pranimin ose rrëzimin e pretendimeve të subjektit në proces dhe në rastin konkret nuk provon pretendimin e subjektit se kjo vlerë u pagua në vitin 2010.

Saktësia dhe mjaftueshmëria e deklaramit për një subjekt deklarimi vlerësohet vetëm përmes deklaramit të sakta dhe të plota, dhe pretendimi i subjektit të rivlerësimit për pagimin e shumës prej 10,000 euro në vitin 2010 rezulton i pambështetur në prova dhe në ligj.

Analiza përfundimtare financiare për pagimin e këstit të dytë të apartamenteve në vitin 2014

Analiza financiare për pagesën e këstit të dytë të apartamenteve	1.1.2014 – 10.1.2014
Pasuritë	1,547,820
Dy ap. banimi, të bashkuara në 1, në bashkëpronësi me bashkëshortin, me sip. 181.2 m ² , ***, Tiranë. Vlera 81,284 euro	1,581,340
<i>Shtesa/pakësime likuiditeteve</i>	<i>(33,520)</i>
Likuiditete në banka	255,518
<i>Cash</i> deklaruar në DPV	-
Gjendja e likuiditeteve	255,518
Detyrime	-
Pasuri net (pasuri - detyrime)	1,547,820
Të ardhurat	33,386
Të ardhurat nga paga, subjekti	0
Të ardhurat nga leja e lindjes	0
Të ardhurat nga aktiviteti si avokat	33,386
Shpenzimet	30,555
Shpenzime jetike	30,555
Mundësia për kursime	-1,544,990

Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur gjenden në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të financuar pagesën e këstit të dytë për blerjen e kësaj pasurie dhe përbalimin e shpenzimeve, situatë faktike e cila kualifikohet sipas përcaktimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim për pasuritë e paluajtshme apartamente banimi në zonën e ***, Tiranë, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të ndodhen në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, si pasojë e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara në kuptim të pikave 1 dhe 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016.

2. Lidhur me automjetin tip “*”, blerë në vitin 2010 me çmimin 980,000 lekë**

Në rezultatet e hetimit administrativ, subjektit lidhur me këtë pasuri iu kalua barra e provës se:

Duket se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur duket se kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 2,686,984 lekë për blerjen e automjetit, për shkak të balancës negative.

Në përfundim të procesit, disa nga pretendimet e ngritura nga subjekti pas kalimit të barrës së provës nuk mund të pranohen e pasqyrohen në analizën financiare, referuar arsyetimit si vijon:

Në deklaratën *Vetting*, subjekti ka deklaruar: “*Automjet tip “***”. Vlera 980,000 lekë, duke depozituar kontratën nr. *** rep., nr. *** kol., datë 30.6.2010, ndërsa bashkëshorti i subjektit si burim krijimi deklaroi kursimet nga të ardhurat e përbashkëta*”.

Në lidhje me burimin e të ardhurave për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2010, subjekti si në deklaratim të interesave periodikë privatë 2010, edhe në deklaratën *Vetting*, ka deklaruar “*Kursimet cash të familjes*”.

Sipas informacionit të ABI Bank, subjekti dhe bashkëshorti i saj janë bashkëmbajtës të llogarisë të bashkëshortit të saj E.L, llogari ku për periudhën 3.3.2010 – 7.6.2010 ka rezultuar se është kredituar në total shuma 23,749 euro.

Në lidhje me lëvizjet monetare në llogaritë dyemërore të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, shpjegimet e dhëna nga subjekti vijnë në kundërshtim me legjislacionin bankar në fuqi në kohën e kryerjes së veprimeve në këtë llogari bankare. Subjekti dhe bashkëshorti i saj konsiderohen referuar legjislacionit mbajtësit e llogarive bankare dhe bashkëzotëues të fondeve të kësaj llogarie.

Fakti që në këto llogari ka vepruar dikush tjetër, që i jepet e drejta të kryejë veprime në kuadër të nivelit të autorizimit të caktuar, sipas njoftimit të autorizimit të bërë nga palët, për bankën personalisht ose me akt noterial, nuk prezumon se ai është zotëues i fondeve të kësaj llogarie.

Subjekti nuk arriti të provojë jo vetëm burimin e ligjshëm të shumave të kredituara, por as destinacionin e përdorimit të tyre, nuk dha shpjegime bindëse për të gjitha faktet e prezantuara dhe nuk arriti të shpjegojë dhe të provojë me provat që njeh legjislacioni procedural situatën faktike e të japë një shpjegim për rrethanat e pretenduara prej saj në aspektin logjik, lidhur me këto transaksione.

Shpjegimi i subjektit dhe provat e sjella prej saj pas kalimit të barrës së provës nuk mund të shërbejnë si provë për të provuar se kapitali i depozituar, në të gjitha rastet, nuk është i bashkëtitullarëve, për sa kohë parashikimet ligjore bankare të vlerësimit të identitetit të klientit përcaktojnë se të dy mbajtësit e llogarisë prezumohet se janë bashkëzotëues të fondeve të llogarisë. Subjekti nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor provues se shumat e kredituara

dhe debituarat nuk janë përfituar nga ajo dhe bashkëshorti dhe nuk janë vënë në funksion të financave të tyre.

Pas analizimit të shpjegimeve të subjektit u morën në konsideratë dhe u ndryshuan vetëm shpenzimet e udhëtimit për vitin 2010, duke i ndryshuar ato nga vlera 507,438 lekë në vlerën 140,788 lekë, pas paraqitjes së dokumentacionit ligjor provues nga ana e subjektit për mbulimin e shpenzimeve të qëndrimit nga të afërmit e saj.

Analiza përfundimtare financiare për blerjen e automjetit në vitin 2010

Analiza financiare përfundimtare për blerjen e automjetit në vitin 2010	1.1.2010 – 25.9.2010
Pasuritë	4,441,164
Dy ap. banimi, të bashkuara në 1, në bashkëpronësi me bashkëshortin, me sip. 181.2 m ² , ***, Tiranë. Vlera 81,284 euro	4,163,100
Automjet tip “****” me targë AA *** LF, blerë më 30.6.2010 (VL *** D)	980,000
<i>Shtesa/pakësime të likuiditeteve</i>	(701,936)
Likuiditete në banka	5,646
Cash deklaruar në DPV	-
Gjendja e likuiditeteve	5,646
Detyrime	3,563,700
Kredia në NBG Bank sipas kontratës datë 11.1.2010	4,163,100
<i>Pagesë kësti (principal + interes)</i>	(599,400)
Pasuri net (pasuri - detyrime)	877,465
Të ardhurat	1,724,278
Të ardhurat nga paga, subjekti	504,080
Të ardhurat nga leja e lindjes	112,448
Të ardhurat nga paga e b/sh	0
Të ardhurat nga aktiviteti si avokat	1,107,750
Shpenzimet	3,308,990
Shpenzime jetike	307,395
Shpenzime udhëtimi	52,733
Shuma të shpenzuara sipas tërheqjeve bankare	2,948,863
Mundësia për kursime	-2,462,177

Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur gjenden në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të financuar blerjen e kësaj pasurie të luajtshme dhe përbalimin e shpenzimeve, situatë faktike e cila kualifikohet sipas përcaktimit të nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

Në konkluzion, lidhur me panoramën e rrethanave faktike për kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit Eranda Laze dhe personi i lidhur me të ndodhen në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm, si pasojë e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar shpenzimet e kryera dhe pasuritë e krijuara, në kuptim të pikave 1 dhe 3, të nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016.

Për rrjedhojë, kam votuar për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Eranda Laze, për sa balancat negative nuk justifikonin zbatimin e parimit të proporcionalitetit dhe konfirmimin e saj në detyrë.

Xhensila PINE
Relatore (kundër)